

Simbolet polake

I nderuar zoti Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit,

I nderuar zoti Ambasador i Polonisë,

Zonja dhe zotërinj,

U ngrita nga vendi kur pashë librin “Simbolet polake” në zyrën e kryetarit të KLSH, zotit Bujar Leskaj, miqësia ime me të cilin ka në themel dashurinë për librin.

Bujari më ka pas befasuar dikur kur në cilësinë e Ministrit të Kulturës mbështeti botimin e kolanës së botimeve françeskane në Shqipëri, një prej thesareve të kulturës sonë kombëtare.

Ai e dinte këtë. Por nuk mund ta dinte se do të më befasonte po njëlloj kur me foli për botimin e librit për Poloninë që po promovojmë sot.

Nuk mund ta dinte se Polonia është për mua një vend që e dua shumë, vendi i admirimit më të lartë, megjithëse kam qenë vetëm dy herë në Vashave dhe nuk më është dhënë rasti ta vizitoj pjesën tjetër të vendit.

Por siç thoshte një poet i madh portugez, Fernandi Pessoa, vendet mund ti njohim pa i parë, me ndihmën e leximeve dhe imagjinatës.

Në fakt, para pak vitesh, revista MAPO më kërkoi t’i përgjigjesha një pyetësori relativisht standard që ua bënte shkrimtarëve të ftuar prej saj.

Pyetja standarde e fundit apo e parafundit ishte “çfarë kombësie do të donit të kishit po të mos ishit shqiptar”.

Kalova rufeshëm nëpër mend hartën e Evropës dhe botës, sa e sa vende të dashura më të cilët të lidh një gjë a një tjetër, për të cilët ke fiksuar në mendje dhe në zemër një kult a shumë kulte dhe si përfundim thashë një përgjigje që mund ta befasojë oportunizmin apo modën politike të kohës. Thashë “do të doja të isha polak”.

Kjo përgjigje është arsyeja që botuesit e këtij libri më kanë ftuar të them dy fjalë për të në këtë promovim shumë të veçantë.

Jam vërtetë i nderuar, e lexova me etje të madhe librin, do ti kthehem përsëri si të isha duke vizituar majat ku ka kaluar historia e Polonisë, galerinë e personazheve të shquar që ky vend i ka dhënë botës.

Duke lexuar librin, pashë se zgjedhja ime për të qenë polak nëse do të kisha mundësi të zgjidhja një kombësi tjetër nga kjo që kam, përforcohej në një numër të madh gjërash të përbashkëta, që nuk i kisha patur parasysh kur i isha përgjigjur pyetjes së MAPO-s, siç mund të përmend pagëzimin e hershëm të dy vendeve në krishterim, betejat e Gjergj Kastriot-Skënderbeu që papa i Romës e kishte quajtur mbrojtës të krishterimit dhe beteja e famshme e Vienës e vitit 1609 që shpëtoi Evropën nga invazioni osman, në të cilën polakët me mbretin e lavdishëm Jan Sobieski dhanë një kontribut heroik vendimtar për fitoren, për të ardhur pastaj tek simboli kombëtar i shqiponjës, të një frymë epike që përcillet ndër shekuj, epikë të cilën për shqiptarët e ka bërë të njohur Bajroni ndërsa për polakët vetë historia e tyre e madhe në zemër të Evropës; dhe më tej akoma mund ti ndjekësh këto përngjasime në mikpritjen dhe bujarinë karakteristike, në statusin që tradita e dy vendeve i jep mikut, të huajit; dhe më tej akoma në fatin e të qenit në udhëkryqin e ngjarjeve diku mes Perëndimit dhe Lindjes, por me fytyrë nga Perëndimi edhe ne, edhe polakët, të shtrënguar shpeshherë në darët e këtij fati që na ka kushtuar sakrifica të mëdha por edhe na ka temperuar si njerëz.

Por unë kisha zgjedhur të isha polak për arsye të tjera. E para, duke u njohur në Varshavë me kryengritjen polake të luftës së dytë botërore, që më mahniti sa herë e kujtoj për shpirtin e paepur të racës polake, por edhe më tronditi, kur kujtoj se si në llogaritë mizore të Luftës aleatët i lanë

vetëm civilët dhe patriotet kryengritës kundër ushtrisë hitleriane. Tronditja ime, thellë-thellë, mendoj se është si një jehonë e pendimit, e vrasjes së ndërgjegjes, e borxheve që bota e lirë i ka Polonisë për sakrificat dhe gjakun e derdhur.

Por Polonia ishte përsëri në krye, në ballë.

Ajo e nisi betejën e re për liri kundër totalitarimit komunist dhe perdes së hekurt.

Ajo i dha botës Kapelanin e Madh, papa Gjon Palin, pastaj Solidarnosin, me Leh Valesën e famshëm.

Ju i dini, të gjithë i dinë të gjitha këto.

Unë kam përsëri arsye të tjera që janë individuale, edhe pse lidhen me fenomene dhe figura publike.

Në të gjitha takimet, seminarët, konferenca a kongreset ku kam marr pjesë si publicist, si shkrimtar apo edhe si ministër a deputet, kam venë re një gjë që ka qenë e pandryshueshme: polakët gjithnjë shkëlqenin. Kur merrte fjalën polaku, po them Adam Miknik, sa për të përmendur një emër, të gjithë mbanin vesh, cilësia e lartë ishte e garantuar.

Por kjo nuk ka mjaftuar.

Është Kapushinski, shkrimtari publicist dhe reporter i pashok, i përkthyer edhe në shqip me vepra të mrekullueshme si Perandori apo Udhërim në Herodotin.

Janë katër nobelistët e mrekullueshëm të Polonisë në letërsi. Është Sinkieviçi që mori nobelin në vitin 1905, autori i romanit “Quo vadis”, ai që ngriti në art doktrinën e fitores në sakrificë. Është Çeslav Milosh, poeti i jashtëzakonshëm, për të cilën vajtoj që e kemi zbuluar kaq vonë këtu në Shqipërinë tonë, nga pena e të cilit kanë dalë vargje të një ligjërimi hyjnor si për shembull (Do të lexoj pesë vargje nga libri i tij); është pastaj një vajzë që nuk arriti të plakej as kur kaloi të tetëdhjetat- ashtu e kishte shikimin dhe buzëqeshjen- Uislava Shimorka. O zot, çfarë poeteje.

Dhe janë njëqind figurat, ngjarjet dhe vendet që kanë gjetur pasqyrim në këtë libër. Dhe janë dyqind a dymijë e kushedi sa mijë që nuk i zë dot asnjë libër por i mban toka polake, kujtesa polake, kujtesa e botës për Poloninë.

Ku shkon Polonia?

George Fridman, në një libër gjeopolitik për të ardhmen e botës, futurology në këtë rast, parasheh një të ardhme kur Polonia dhe Turqia si dy fuqi vitale të rritura do të ndajnë zonat e influencës në Ballkan. Shqipëria do të jetë në sferën e qytetërimit polak, thotë ai duke nënkuptuar me agjekstivin polak Evropën e së ardhmes. Në parashikimin e Fridman do të jemi polakë, domethënë evropianë, të gjithë. Dhe do të jetë mirë.